



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 164

Tiranë – E mërkurë, 31 gusht 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 584, datë 27.7.2016	Për standardizimin e mënyrës së klasifikimit dhe kodifikimit të shërbimeve publike dhe të hartimit të formularëve për aplikimin në shërbime..... 20139
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 13, datë 22.7.2016	Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016–2017..... 20142
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 15, datë 1.8.2016	Për disa shtesa në udhëzimin nr. 13, datë 22.7.2016, “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016–2017..... 20149
Udhëzim i ministrit të Mjedisit nr. 3, datë 27.7.2016	Për përcaktimin e rregullave për aplikimin për regjistrimin e një kimikati industrial..... 20149
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë nr. 360, datë 22.8.2016	Mbi procedurat dhe rregullat për regjistrimin e pajisjeve mjekësore ndryshimet dhe anulimin e regjistrimit të tyre, dokumentacionin e nevojshëm dhe kostot përkatëse..... 20153

**VENDIM****Nr. 584, datë 27.7.2016**

**PËR STANDARDIZIMIN E MËNYRËS SË
KLASIFIKIMIT DHE KODIFIKIMIT TË
SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE TË
HARTIMIT TË FORMULARËVE PËR
APLIKIMIN NË SHËRBIME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 36 e 56, të ligjit nr. 13/2016, “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Objekti i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave për standardizimin e mënyrës së klasifikimit, kodifikimit dhe hartimit të formularëve për aplikimin në shërbime publike, të ofruara në Republikën e Shqipërisë.

2. Klasifikimi i shërbimeve bëhet me qëllimin e pajisjes së tyre me një kod unik për çdo shërbim publik që u ofrohet përdoruesve, personave fizikë dhe juridikë.

KREU I

**MËNYRA E KLASIFIKIMIT DHE
KODIFIKIMIT TË SHËRBIMEVE**

3. Klasifikimi i shërbimeve publike në Shqipëri bëhet me tri nivele hierarkie:

a) Niveli i parë është “Funksioni”, i cili pasqyron ndarjen tematike, sipas llojeve të shërbimeve që paraqesin, në vija të përgjithshme, karakteristika të përbashkëta dhe përmban grupe shërbimesh;

b) Niveli i dytë është “Grupi i shërbimeve”, i cili pasqyron një nënndarje të funksionit sipas nëntematikave specifike. Shërbimet që i përkasin një grupi janë të ngjashme ndërmjet tyre dhe të dallueshme nga grupet e tjera brenda funksionit, për shkak të llojit apo qëllimit që ka grupi;

c) Niveli i tretë është “Shërbimi”, si njësi më e vogël bashkuese e klasifikimit, e cila pasqyron një shërbim publik unik, për të cilin aplikohet më vete. Shërbimi ofrohet brenda grupit të shërbimeve dhe është i dallueshëm nga shërbimet e tjera nga lloji apo qëllimi.

4. Kodi unik që i vendoset çdo shërbimi publik ka për qëllim identifikimin e unifikuar të shërbimeve në Republikën e Shqipërisë, në shkëm-

bimet me personat fizikë dhe juridikë, si edhe ndërmjet institucioneve të administratës shtetërore.

5. Kodifikimi i shërbimeve publike pasqyron klasifikimin e shërbimeve publike, duke u vënë, në korrespondencë, një kod shifror të tria niveleve të klasifikimit, funksionit, grupit të shërbimeve dhe shërbimit, të paraprirë nga prefiksi AL.

6. Kodi i shërbimit është unik për çdo shërbim dhe ka formatin AL 00 00 00, sipas mënyrës së pasqyruar në tabelën vijuese:

Kodi prefiks	Funksioni	Grupi i shërbimeve	Kodi i shërbimit	Përshkrimi i shërbimit
AL	00	00	00	Shërbimi AAA

7. Kodi i prefiksit përbëhet nga kombinimi i shkronjave “AL”, me qëllim identifikimin e shtetit. Këto dy karaktere qëndrojnë, gjithmonë, në fillim të kodit dhe pasohen nga elementet e tjera të tij.

8. Kodi i funksionit përbëhet nga një numër dyshifror, natyror, i cili pason kodin e prefiksit. Ky kod fillon me numrin “01” dhe ka rend progresiv.

9. Kodi i grupit të shërbimeve përbëhet nga një numër dyshifror, natyror, i cili pason kodin e funksionit. Kodi i grupit të shërbimit fillon me numrin “10” dhe rritet progresivisht me 10 numra për çdo grup (p.sh.: grupi 10, grupi 20, ..., grupi 90).

10. Kur një funksion përfshin më shumë se nëntë grupe shërbimesh, kodet e mëtejshme të grupeve të shërbimit fillojnë me numrin “05” dhe rriten progresivisht me 10 numra (p.sh.: grupi 05, grupi 15, ..., grupi 95).

11. Kodi i shërbimit përbëhet nga një numër dyshifror, natyror, dhe pason kodin e grupit të shërbimeve. Ky kod fillon me numrin “01”, ka rend progresiv dhe përfundon me numrin “99”.

12. Secili grup shërbimesh nuk mund të përmbajë më shumë se 99 shërbime specifike. Në rast të përfundimit të numrave brenda një grupi, për shërbimet e reja krijohet një grup shërbimi i ri, në përputhje me specifikat e shërbimeve.

13. Formulari për aplikim ka, gjithashtu, kod unik, i cili pason kodin e shërbimit dhe ndahet prej tij me shenjën “-”. Ky kod ka formatin 0vv. Shifra e parë e kodit fillon me numrin “1” dhe ka rend progresiv dhe dy shifrat e tjera tregojnë vitin në të cilin është krijuar dhe/ose ndryshuar formulari.

14. Kodi i formularit të aplikimit vendoset si vazhdimësi e kodit të shërbimit, në formatin AL 00 00 00-0vv.



KREU II

MODELI I FORMULARIT TË APLIKIMIT

15. Modeli i formularit të aplikimit ka për qëllim unifikimin dhe përmirësimin e marrjes së aplikimeve nga personat fizikë e juridikë prej të gjitha institucioneve të administratës shtetërore që ofrojnë shërbime publike.

16. Formulari i aplikimit është dokumenti, nëpërmjet të cilit institucioni mbledh informacionin e nevojshëm për aplikuesin, për të filluar lëvrimin e shërbimit.

17. Elementet bazë të formularit për aplikim, të standardizuar, janë: pjesa hyrëse e formularit, seksionet e brendisë dhe pjesa përmbyllëse e tij. Nga pikëpamja vizuale, këto elemente duhet të vendosen sipas formatit të paraqitur në lidhjen nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

18. Formulari për aplikim duhet të jetë i kodifikuar, sipas rregullave të vendosura në kreun II, të këtij vendimi, në mënyrë që shërbimi përkatës të jetë i identifikueshëm në mënyrë unike.

19. Formulari për aplikim plotësohet për çdo pjesë ose seksion, sipas përcaktimeve të dhëna në lidhjen nr. 1.

20. Ngarkohen autoriteti përgjegjës për modelet dhe institucionet e administratës shtetërore, të cilat ofrojnë shërbime publike, për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja nr. 1

SHPJEGIMI I SEKSIONEVE TË
FORMULARIT

1. Në pjesën hyrëse të çdo formulari (për çdo institucion) do të jenë këto elemente, të vendosura në linjë horizontale, si më poshtë vijon:

a) Stema e Republikës së Shqipërisë, e vendosur në krahun e majtë;

b) Formular aplikimi/titulli i formularit të aplikimit/emri i institucionit/emri i ministrisë së linjës. Këto elemente pozicionohen në qendër;

c) Barkodi dydimensional vendoset në krah të djathtë dhe shifron të dhëna të formularit me karakter informues;

ç) Më poshtë vijon kuadrati me të dhënat e kontaktit të institucionit, i cili, sipas rastit dhe llojit të shërbimit mund të plotësohet me të dhëna të tilla, si: telefoni, posta elektronike, faqja zyrtare e internetit etj.;

d) Elementet e mësipërme janë të vendosura mbi fushë të bardhë.

2. Seksionet e brendisë janë të vendosura mbi fushë gri dhe janë të strukturuar, si më poshtë vijon:

a) Seksioni “Informacion specifik mbi aplikantin” paraqet të gjitha fushat e të dhënave që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me aplikantin përfitues të shërbimit. Në këtë seksion aplikanti duhet të plotësojë të dhënat personale dhe ai përmban, sipas rastit dhe llojit të shërbimit të kërkuar, të dhëna që tregojnë gjenealogjet e tij, adresën e vendbanimit dhe mënyrën e kontaktimit të tij (numri i telefonit fiks dhe/ose celular, adresa e postës elektronike) etj. Në rast se aplikanti është person fizik, atëherë plotësohet edhe rubrika me numrin personal që pasqyrohet në letërnjoftim. Në rast se aplikanti është person juridik, atëherë plotësohet rubrika me numrin unik të identifikimit të subjektit (NUIS).

b) Seksioni “Informacion specifik mbi aplikimin” mund të përbëhet nga disa pjesë, të cilat organizohen, logjikisht, sipas fushave të të dhënave të domosdoshme për marrjen e shërbimit. Në të, sipas rastit dhe llojit të shërbimit të kërkuar, mund të përfshihen disa fusha, të përcaktuara në varësi të shërbimit që kërkohet.

c) Seksioni “Dokumentacioni i paraqitur” liston të gjitha dokumentet e nevojshme për marrjen e shërbimit, si dhe tipin e dokumentit, origjinal apo kopje. Përcaktimi i këtij seksioni bëhet me qëllim zhvillimin e transparencës dhe rrit sigurinë e aplikuesit në marrjen e shërbimit.

3. Pjesa përmbyllëse mbi fushën gri përmban këto elemente:

a) Nënshkrimin e aplikantit (në rast se aplikimi bëhet nëpërmjet mjeteve elektronike, atëherë përdoret nënshkrimi elektronik);

b) Nënshkrimin e punonjësit të institucionit, vetëm në rast se institucioni pranues i aplikimit e ka detyrim ligjor nënshkrimin e formularit nga ana e tij;

c) Datën e dorëzimit të aplikimit;

ç) Shënimin e përgjegjësisë mbi vërtetësinë e deklarimeve të plotësuara në formular;



d) Shënimin: “Ky formular është i standardizuar nga ADISA”;

dh) Numërimin e faqeve të formularit në formatin “faqe 1/2”, në fund të faqes, në anën e majtë.

4. Në fundin e çdo faqeje të formularit, në të djathtë, vendoset kodi unik i formularit.

5. Formulari shoqërohet me udhëzimin përkatës, në të cilin sqarohet mënyra e plotësimit të tij.

FORMULAR APLIKIMI EMRI I SHËRBIMIT EMRI I INSTITUCIONIT EMRI I MINISTRISË SË LINJËS		
Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni: Tel: E-mail: Web: <i>Shënim: Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë.</i>	HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN	
SEKSIONI A1-An: INFORMACION MBI APLIKANTIN		
NID / NUIS		
SEKSIONI B1-Bn: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN		
SEKSIONI C: DOKUMENTACIONI I PARAQITUR		
KLAUZOLA DEKLARATIVE		
Unë i/e nënshkruari/a _____ në dijeni të përgjegjësi ve penale që rrjedhin nga deklarimi dhe paraqitja e të dhënave e rrethanave të rreme, nën përgjegjësinë time personale deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta.		
Nënshkrimi i Aplikantit		Data Muaji Viti
Personi i Autorizuar		Data Muaji Viti
Ky formular është standardizuar nga ADISA		
		AL000000-000

**UDHËZIM****Nr. 13, datë 22.7.2016****PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, ME KOHË TË PLOTË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2016–2017**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 407, datë 1.6.2016, “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016–2017”,

UDHËZOJ:

I. Hedhja e të dhënave në portalin e maturantit dhe përzgjedhja e programeve të studimit në portalin e Maturës Shtetërore *on-line*

1. Portali i maturantit është një sistem elektronik baze të dhënash, i cili administron të dhënat e rezultateve të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë.

2. Përzgjedhja e programeve të studimit dhe regjistrimi i fituesve të shpallur nga IAL-të, sipas kriterëve të përcaktuara me vendim senati prej tyre, i maturantëve/kandidatëve në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë (IAL), në vitin akademik 2016–2017, do të bëhet nëpërmjet “Portali i Maturës Shtetërore *on-line*”. Ky portal është sistem elektronik baze të dhënash, i cili administron:

a) procedurat e aplikimit nga maturantët/kandidatët me formularët A1 dhe A1Z;

b) rezultatet e Maturës Shtetërore;

c) procesin e përzgjedhjes së preferencave në programet e studimit të IAL-ve (publike dhe jopublike);

d) regjistrimin e studentëve të shpallur fitues nga IAL-të.

3. Përzgjedhja e programeve të studimit nga maturantët/kandidatët për programet e ciklit të parë të studimeve, për programet e studimeve me karakter profesional dhe për programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë (IAL), në vitin akademik 2016–2017, fillon pas përfundimit të procesit të hedhjes nga drejtoritë e shkollave në portalin *on-line* të maturantit, të të dhënave lidhur me rezultatet e shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë.

4. Për të gjithë maturantët e vitit shkollor 2015–2016, të cilët kanë aplikuar me formularin A1, nga drejtoritë e shkollave hidhen në portalin *on-line* të maturantit të gjitha të dhënat e lidhura me rezultatet e shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm.

5. Për kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë përpara vitit shkollor 2015–2016 dhe që kanë aplikuar me formularin A1Z, nga drejtoritë e shkollave, ku ata kanë kryer aplikimin, hidhen në portalin *on-line* të maturantit të gjitha të dhënat e lidhura me rezultatet e shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm.

6. Për të gjithë kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm jashtë vendit dhe që kanë aplikuar me formularin A1Z, nga drejtoritë e shkollave, ku ata kanë kryer aplikimin, hidhen në portalin *on-line* të maturantit të gjitha të dhënat e lidhura me rezultatet e shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm.

II. Raundi i parë i aplikimeve

1. Të gjithë kandidatët, për ndjekjen e studimeve në institucionet e arsimit të lartë, publike dhe jopublike, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional dhe në programet e integruara të studimeve të dytë, me kohë të plotë, duhet të kryejnë procesin e aplikimit *on-line* në portalin e Maturës Shtetërore.

2. Aplikimi të kryhet nga kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë, janë pajisur me dokumentacionin ligjor të përfundimit të këtij niveli arsimor, nuk rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi, në IAL-të publike



dhe/ose jopublike, plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe plotësojnë kriteret e përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë për programet e studimit për të cilat aplikojnë.

3. Kandidatët, përpara aplikimit në portalin e Maturës Shtetërore, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit në vlerën 2000 lekë, në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë, nëpërmjet faturës së publikuar në faqen zyrtare elektronike të AKP-së.

4. Mandati i pagesës dorëzohet në shkollën përkatëse, ku kandidatët kanë kryer plotësimin e formularit A1/A1Z. Pas dorëzimit të mandatit të pagesës, sekretaritë e shkollave hedhin në sistem notën mesatare të llogaritur sipas VKM-së nr. 407, datë 1.6.2016, “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016–2017”, deri më 10 gusht 2016.

5. Kandidatët që aplikojnë për t’u pranuar në programet e studimeve dyvjeçare me karakter profesional, nuk kanë detyrimin të plotësojnë kriterin e notës mesatare të parashikuar në VKM-në nr. 407, datë 1.6.2016.

6. Të gjithë kandidatët që duan të ndjekin studimet në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, përfshirë edhe kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm jashtë vendit, pas pagesës së tarifës së aplikimit dhe hedhjes në sistem të notës mesatare, do të aplikojnë në portalin e Maturës Shtetërore, nëpërmjet formularit të aplikimit, për çdo DAR/ZA sipas kalendarit bashkëlidhur këtij udhëzimi, në datat 1–11 gusht 2016.

7. Aplikimi nëpërmjet formularit të aplikimit në portalin e Maturës Shtetërore në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016–2017, kryhet në cilindo mjedis që ka akses interneti (sipas procedurave të përshkruara në udhëzuesin teknik të publikuar në faqen zyrtare të AKP-së). Kandidatët aksesohen në portal me kredencialet e tyre: ID-në e kandidatit; emri, atësia, mbiemri; karta e identitetit; *e-mail*-i i kandidatit etj., duke

zgjedhur deri në 10 (dhjetë) programe studimi nga lista e programeve të studimit që ofrohen nga IAL-të publike dhe/ose jopublike, për vitin akademik 2016–2017.

8. Portali i Maturës Shtetërore nuk do të pranojë aplikime nga kandidatët të cilët nuk plotësojnë kriterin e notës mesatare, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave për programet e ciklit të parë të studimeve dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë, si dhe kriteret specifike të përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë.

9. AKP-ja u përcjell IAL-ve që parashikojnë konkurse pranimi, në format elektronik dhe zyrtarisht, brenda datës 16 gusht 2016, listën e aplikantëve që konkurrojnë në programet përkatëse të studimit.

10. AKP-ja u përcjell IAL-ve, në format elektronik dhe zyrtarisht, brenda datës 30 gusht 2016, për çdo program studimi të ofruar nga ana e tyre, listën e kandidatëve që kanë përzgjedhur ato programe studimi, së bashku me notat e të gjitha viteve të shkollës së mesme, rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore, si dhe tregues vlerësimi të tjerë të nevojshëm për renditjen dhe shpalljen e fituesve nga ana e IAL-ve.

11. Të gjitha IAL-të publike dhe jopublike që në kriteret e tyre kanë përcaktuar konkurs/testime etj., do t’i afishojnë listat e pjesëmarrësve në konkurset e pranimi, në datën 16 gusht 2016, në mjediset e tyre dhe në faqet zyrtare elektronike përkatëse, si dhe do të realizojnë këto konkurse, në periudhën 20 deri 30 gusht 2016.

12. Brenda datës 4 shtator 2016, IAL-të, e pikës 11 të këtij kreu, hedhin në sistemin informatik pikët e secilit kandidat në konkurrim.

13. Çdo IAL që zhvillon konkurse për pranimin në programet përkatëse të studimit që ofron, pas kryerjes së përllogaritjeve të pikëve për çdo konkurrent, sipas kriteve të pranimi të përcaktuara nga IAL-ja, si dhe pas renditjes së studentëve në varësi të pikëve të grumbulluara, afishon në mjedise publike si dhe në faqen e saj zyrtare listat e renditjes së aplikuesve, ku fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit me konkurs. Afishimi dhe publikimi duhet bërë brenda datës 5.9.2016. Një kopje elektronike e këtyre listave i përcillet AKP-së brenda datës 6.9.2016.



14. IAL-të të kryejnë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve fitues në bazë të kriterëve të përcaktuara nga ana e tyre. IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat e renditjes së kandidatëve dhe formulën/mënyrën e përzgjedhjes. Në listën e publikuar, fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit.

15. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit në IAL brenda tri ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së rezultateve. IAL-të detyrohen të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave. Vendimet e IAL-ve ankimohen në gjykatën kompetente.

16. IAL-të shpallin listat jopërfundimtare të kandidatëve fitues të identifikuar me ID-në e kandidatit, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, brenda datës 5.9.2016, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Një kopje elektronike e këtyre listave i përcillet AKP-së brenda datës 6.9.2016.

17. IAL-të, pas përfundimit të afatit të ankimit dhe shqyrtimit të ankesave, shpallin listat përfundimtare të kandidatëve fitues të identifikuar me ID-në e kandidatit, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, brenda datës 11.9.2016, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Një kopje elektronike e këtyre listave i përcillet AKP-së brenda datës 12.9.2016.

18. Të gjithë kandidatët, të cilët kanë kryer procesin e aplikimit në raundin e parë dhe janë shpallur fitues nga IAL-të, duhet të kryejnë procesin e regjistrimit *on-line* dhe me dokumentacion në sekretaritë mësimore të IAL-ve në programin e studimit ku dëshirojnë të vazhdojnë studimet, në datat 13–20 shtator 2016. Kandidati që është shpallur fitues në më shumë se një program studimi, lejohet të regjistrohet vetëm në njërin nga programet e studimit ku është fitues.

19. Sekretaritë mësimore të IAL-ve do të pranojnë dokumentacionin për të gjithë kandidatët fitues. Kandidatët dorëzojnë personalisht, ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar nga ana e tyre, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Dokumentin e identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja e një prej dokumenteve të identifikimit;

b) Fotokopjen e noterizuar të diplomës së Maturës Shtetërore ose dëftesës së pjekurisë, së bashku me certifikatën e notave, ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit dhe të njësuar në MAS;

c) Deklaratën e paraqitur në shtojcën bashkëlidhur këtij udhëzimi, e cila plotësohet nga kandidati në prani të punonjësës së sekretarisë mësimore të IAL-së dhe nënshkruhet nga kandidati dhe nga kjo e fundit;

d) Dy fotografi personale.

20. Sekretaritë mësimore të fakulteteve të IAL-ve mbajnë regjistrë të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit me të dhënat mbi datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e kandidatëve të regjistruar. Kandidati, pasi ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjistrë, nuk ka të drejtë të ndryshojë programin e studimit, për atë vit akademik.

III. Raundi i dytë i aplikimeve

1. Për të gjithë maturantët që kanë rezultuar kalues në provimet e sesionit të dytë (sesioni i vjeshtës), nga drejtoritë e shkollave hidhen në portalin *on-line* të maturantit, të gjitha të dhënat e lidhura me rezultatet e shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm menjëherë pas publikimit të rezultateve të provimeve të këtij sesioni.

2. Të gjitha IAL-të, brenda datës 22 shtator 2016, i dërgojnë AKP-së numrin e kuotave të paplotësuara për çdo program studimi, në rrugë elektronike dhe zyrtare.

3. Të gjithë kandidatët, të cilët kanë plotësuar formularin A1/A1Z dhe rezultojnë kalues në provimet e Maturës Shtetërore, por nuk kanë arritur të aplikojnë në raundin e parë për arsye të ndryshme dhe kandidatët që kanë kryer procesin e aplikimit *on-line* në raundin e parë dhe nuk janë shpallur fitues apo nuk kanë arritur të regjistrohen, të kryejnë procesin e aplikimit *on-line* në raundin e dytë me formularin e aplikimit në portalin e Maturës Shtetërore duke bërë 10 (dhjetë) përzgjedhje preferencash, për çdo DAR/ZA sipas kalendarit bashkëlidhur këtij udhëzimi në datat 23 shtator – 1 tetor 2016.

4. Aplikimi kryhet në cilindo mjedis që ka akses interneti (sipas procedurave të përshkruara në udhëzuesin teknik të publikuar në faqen zyrtare të AKP-së).

5. Kandidatët që nuk kanë aplikuar në raundin e parë, përpara aplikimit në portalin e Maturës



Shtetërore, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit në vlerën 2000 lekë dhe e paraqesin në sekretarinë e shkollës, ku kandidatët kanë kryer plotësimin e formularit A1/A1Z.

6. Pas dorëzimit të mandatit të pagesës, sekretaritë e shkollave hedhin në sistem notën mesatare të llogaritur sipas VKM-së nr. 407, datë 1.6.2016, në datat 22–29 shtator 2016.

7. AKP-ja u përcjell IAL-ve, në format elektronik dhe zyrtarisht, brenda datës 4 tetor 2016, për çdo program studimi të ofruar nga ana e tyre, listën e kandidatëve që kanë përzgjedhur ato programe studimi, së bashku me notat e të gjitha viteve të shkollës së mesme, rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore, si dhe tregues vlerësimi të tjerë të nevojshëm për renditjen dhe shpalljen e fituesve nga ana e IAL-ve.

8. IAL-të të kryejnë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve fitues në bazë të kriterëve të përcaktuara nga ana e tyre. IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat e renditjes së kandidatëve dhe formulën/mënyrën e përzgjedhjes.

9. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit në IAL, brenda tri ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së rezultateve. IAL-të detyrohen të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave. Vendimet e IAL-ve ankimohen në gjykatën kompetente.

10. IAL-të shpallin listat jopërfundimtare të kandidatëve fitues të identifikuar me ID-në e kandidatit, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, brenda datës 6 tetor 2016, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Një kopje elektronike e këtyre listave i përcillet AKP-së brenda datës 7 tetor 2016.

11. IAL-të, pas përfundimit të afatit të ankimit dhe shqyrtimit të ankesave, shpallin listat përfundimtare të kandidatëve fitues të identifikuar me ID-në e kandidatit, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, brenda datës 12 tetor 2016, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Një kopje elektronike e këtyre listave i përcillet AKP-së brenda datës 13 tetor 2016.

12. Të gjithë kandidatët, të cilët kanë kryer procesin e aplikimit në raundin e dytë dhe janë shpallur fitues nga IAL-të, duhet të kryejnë

procesin e regjistrimit *on-line* dhe me dokumentacion në sekretaritë mësimore të IAL-ve, në programin e studimit ku dëshirojnë të vazhdojnë studimet, deri në datën 16 tetor 2016. Kandidati që është shpallur fitues në më shumë se një program studimi, lejohet të regjistrohet me dokumentacion vetëm në njërin nga programet e studimit ku është fitues.

13. Pas datës 16 tetor 2016, deri në datën 20 tetor 2016, sekretaritë mësimore të IAL-ve do të regjistrojnë *on-line* dhe me dokumentacion, deri në plotësimin e numrit të kuotave për programin e studimit përkatës, të gjithë kandidatët e tjerë që kërkojnë të regjistrohen, duke respektuar renditjen në lista. Kandidati nuk mund të regjistrohet në më shumë se një program studimi.

14. Sekretaritë mësimore të IAL-ve do të pranojnë dokumentacionin për të gjithë kandidatët që do të regjistrohen. Kandidatët dorëzojnë personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar nga ana e tyre, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Dokumentin e identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja e një prej dokumenteve të identifikimit.

b) Fotokopje të noterizuar të diplomës së Maturës Shtetërore ose dëftesës së pjekurisë, së bashku me certifikatën e notave, ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit dhe të njësuar në MAS.

c) Deklaratën e paraqitur në shtojcën bashkëlidhur këtij udhëzimi, e cila plotësohet nga kandidati në prani të punonjësës së sekretarisë mësimore të IAL-së dhe nënshkruhet nga kandidati dhe nga kjo e fundit.

d) Dy fotografi personale.

15. Sekretaritë mësimore të IAL-ve mbajnë regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit me të dhënat mbi datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e kandidatëve të regjistruar. Kandidati, pasi ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjistër, nuk ka të drejtë të ndryshojë programin e studimit, për atë vit akademik.

IV. Aplikimi nga kandidatë shtetas të huaj

1. Të gjithë kandidatët shtetas të huaj që dëshirojnë të ndjekin studimet në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit



të lartë në Republikën e Shqipërisë, paraqesin vetë apo nëpërmjet përfaqësuesve të tyre, kopje të dokumenteve me të dhënat e rezultateve të të gjitha viteve shkollore të arsimit të mesëm dhe mandatin e arkëtimit të tarifës së aplikimit në shkollat apo institucionet arsimore të autorizuar nga MAS-i.

2. Aplikimi me formularin A1Z kryhet në shkollat apo institucionet arsimore të autorizuar nga MAS për hedhjen në portalin e Maturës Shtetërore të rezultateve të provimeve të MSH-së dhe notës mesatare, të njësuar në MAS, nën mbikëqyrjen e specialistëve të DAR/ZA-ve dhe MAS-it, në datat 31 gusht 2016–4 shtator 2016.

3. Kandidatët shtetas të huaj duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm të lartë dhe të jenë të pajisur me dokumentacionin ligjor të përfundimit të këtij niveli arsimor, nuk duhet të rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi në IAL-të publike dhe/ose jopublike, të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë, për programet e studimit për të cilët aplikojnë.

4. Kandidatët shtetas të huaj, përpara aplikimit në portalin e Maturës Shtetërore, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit në vlerën 2000 lekë, në zyrat e Postës Shqiptare apo bankat e nivelit të dytë, nëpërmjet faturës së publikuar në faqen zyrtare elektronike të AKP-së.

5. Kandidatët shtetas të huaj që aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimeve dyvjeçare me karakter profesional, nuk kanë detyrimin të plotësojnë kriterin e notës mesatare të parashikuar në VKM-në nr. 407, datë 1.6.2016.

6. Kandidatët shtetas të huaj, për ndjekjen e studimeve në institucionet e arsimit të lartë, në programet e ciklit të parë, atyre të integruara dhe programet me karakter profesional, duhet të kryejnë procesin e aplikimit *on-line*, për kuotat për shtetasit e huaj, në portalin e Maturës Shtetërore, sipas procedurave të përshkruara në udhëzuesin teknik të publikuar në faqen zyrtare të AKP-së, në datat 5–10 shtator 2016.

7. Kandidatët shtetas të huaj aplikojnë me formularin e aplikimit, duke zgjedhur deri në 10 (dhjetë) programe studimi nga lista e programeve të studimit që ofrohen nga IAL-të, për vitin akademik 2016–2017.

8. Pasi ka përfunduar procesin e aplikimit në portalin e Maturës Shtetërore, AKP-ja u përcjell IAL-ve, në format elektronik dhe zyrtarisht, për çdo program studimi të ofruar nga ana e tyre, listën e kandidatëve shtetas të huaj që kanë përzgjedhur ato programe studimi, së bashku me notën mesatare të viteve të shkollës së mesme.

9. IAL-të kryejnë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve fitues, në bazë të kuotave dhe kriterëve të përcaktuara nga ana e tyre, në datat 11–14 shtator 2016.

10. IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat me renditjen e kandidatëve sipas të dhënave të përcjella nga AKP-ja dhe mënyrën /formulën e përzgjedhjes së kandidatëve. Në listën e publikuar nga ana e IAL-ve, fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit.

11. Të gjithë kandidatët shtetas të huaj, të cilët kanë kryer procesin e aplikimit *on-line* dhe janë shpallur fitues, duhet të paraqiten në sekretariatë mësimore të IAL-ve dhe të regjistrohen me dokumentacion në programin e studimit përkatës. Regjistrimi nga sekretariatë do të kryhet brenda datave 15–20 shtator 2016.

12. Kandidati shtetas i huaj që është shpallur fitues në më shumë se një program studimi, lejohet të regjistrohet me dokumentacion vetëm në njërin nga programet e studimit ku është fitues.

13. Sekretariatë mësimore të IAL-ve do të pranojnë dokumentacionin për të gjithë kandidatët fitues. Shtetasit e huaj dorëzojnë personalisht, ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar nga ana e tyre, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Vërtetimin që nuk ka qenë i ndjekur penalisht dhe që nuk është në ndjekje penale, në vendin e origjinës, i lëshuar tre muajt e fundit;

b) Fotokopjen e dokumentit personal të identitetit;

c) Fotokopjen e njësuar me origjinalin të vërtetimit të njohjes në Republikën e Shqipërisë nga komisioni i posaçëm për njohjen e diplomave të arsimit të mesëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit;

d) Dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, fituar në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës (për rastet kur regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe), si dhe të gjuhëve të tjera të njohura nga kandidati. Shtetasit e huaj që kanë



kombësi shqiptare dhe kanë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe, mund të sjellin çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e gjuhës shqipe;

e) Autorizimin për trajtimin e të dhënave personale sipas shtojcës bashkëlidhur këtij udhëzimi.

14. Sekretaritetë mësimore të IAL-ve mbajnë regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit me të dhënat mbi datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e kandidatëve të regjistruar. Kandidati, pasi ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjistër, nuk ka të drejtë të ndryshojë programin e studimit, për atë vit akademik.

V. Dispozita kalimtare dhe hyrja në fuqi

1. Aplikimi për kuotat e veçanta, për kandidatët nga Republika e Kosovës, kandidatët me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, si dhe kandidatët me status të verbri, invalidi paraplegjik dhe tetraplegjik, jetim, rom dhe egjiptian do të bëhet në institucionet e arsimit të lartë, sipas përcaktimeve të udhëzimit të posaçëm të MAS-it.

2. Aplikimi për program të dytë studimi dhe për transferimin e studimeve do të bëhet në institucionet e arsimit të lartë, sipas përcaktimeve të udhëzimit të posaçëm të MAS-it.

3. IAL-të të dorëzojnë në AKP, në formë zyrtare dhe elektronike, brenda datës 30 nëntor

2016, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar për pajisjen e studentëve me numër matrikullimi, sipas udhëzimit nr. 45, datë 19.12.2011, “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”, të ndryshuar, si dhe deklaratën sipas shtojcës bashkëlidhur këtij udhëzimi. AKP-ja u dërgon IAL-ve, brenda datës 31.12.2016, numrat individualë të regjistrimit (matrikullimit) të studentëve të regjistruar.

4. Kandidatët e shpallur fitues në programet e studimit me kohë të plotë nuk mund të regjistrohen për të ndjekur njëkohësisht studimet në dy programe studimi në IAL-të publike dhe/ose jopublike, në të njëjtin vit akademik.

5. IAL-të të përpilojnë një raport të hollësishëm në lidhje me regjistrimet e studentëve në afatet dhe formatet e kërkuara sipas udhëzimit nr. 9, datë 25.2.2010, “Për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore”. Ky raport të dërgohet në MAS, brenda datës 15 dhjetor 2016.

6. Ngarkohen, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve, DAR/ZA-të dhe IAL-të, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

SHTOJCA 1

DEKLARATË

Unë i nënshkruari _____, lindur më _____, me kartë identiteti, pasaportë nr. _____.

1. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë _____, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve, për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin eventuale të tyre. Autorizoj, gjithashtu Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve, për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve, që lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.

2. Deklaroj se nuk kam aplikuar për t'u regjistruar në asnjë institucion tjetër të arsimit të lartë, për vitin akademik 2016–2017.

3. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

4. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo



të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe/ose Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

Emër, atësi, mbiemër i kandidatit _____

Emër, atësi, mbiemër i punonjësit të sekretarisë mësimore _____

Firma: _____

Firma: _____

Vendi: _____

Data: ____ . ____ . ____

SHTOJCA 2

KALENDARI I APLIKIMEVE PËR RAUNDIN E PARË

Planit kalendar i aplikimit *on-line* me formularin e aplikimit në IAL

Datë	DAR/ZA							
1.8.16	Tirana qytet	Tirana qark						
2.8.16	Tirana qytet	Tirana qark						
3.8.16	Tirana qytet	Tirana qark	Kamëz	Kavajë	Durrës	Krujë		
4.8.16	Elbasan	Peqin	Gramsh	Librazhd	Korçë	Pogradec	Kolonjë	Devoll
5.8.16	Fier	Mallakastër	Lushnjë	Berat	Kuçovë	Skrapar		
8.8.16	Shkodër	M. e Madhe	Pukë	Lezhë	Kurbin	Mirditë		
9.8.16	Vlorë	Sarandë	Delvinë	Gjirokastër	Tepelenë	Përmet		
10.8.16	Kukës	Has	Tropojë	Dibër	Mat	Bulqizë		

SHTOJCA 3

KALENDARI I APLIKIMEVE PËR RAUNDIN E DYTË

Planit kalendar i aplikimit *on-line* me formularin e aplikimit për kuotat e paplotësuara

Datë	DAR/ZA							
23.9.16	Tirana qytet	Tirana qark						
24.9.16	Tirana qytet	Tirana qark						
25.9.16	Tirana qytet	Tirana qark	Kamëz	Kavajë	Durrës	Krujë		
26.9.16	Elbasan	Peqin	Gramsh	Librazhd	Korçë	Pogradec	Kolonjë	Devoll
27.9.16	Fier	Mallakastër	Lushnjë	Berat	Kuçovë	Skrapar		
28.9.16	Shkodër	M. e Madhe	Pukë	Lezhë	Kurbin	Mirditë		
29.9.16	Vlorë	Sarandë	Delvinë	Gjirokastër	Tepelenë	Përmet		
30.9.16	Kukës	Has	Tropojë	Dibër	Mat	Bulqizë		

SHTOJCA 4

KALENDARI I APLIKIMEVE PËR STUDENTËT E HUAJ

Planit kalendar i aplikimit *on-line* me formularin e aplikimit për shtetas të huaj

1. Nga datat 31 gusht 2016 deri në datën 4 shtator 2016, aplikime me formularin A1Z dhe pasqyrimin e notës mesatare.
2. Nga datat 5 deri në datën 10 shtator 2016 aplikimi në IAL.

**UDHËZIM****Nr. 15, datë 1.8.2016****PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN
NR. 13, DATË 22.7.2016, “PËR
PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË
REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E
CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË
PROGRAMET E STUDIMEVE ME
KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË
PROGRAMET E INTEGRUARA TË
STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, NË
INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË,
PËR VITIN AKADEMIK 2016–2017**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 407, datë 1.6.2016, “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016–2017”,

UDHËZOJ:

Pas kreut IV, të udhëzimit nr. 13, datë 22.7.2016, shtohet kreu IV/1, si më poshtë:

1. Zhvillimi i procedurave të aplikimit dhe të regjistrimit në programet e studimit objekt të këtij udhëzimi, në IAL-të që i zhvillojnë këto programe, si programe të përbashkëta studimi, që përfundojnë me një diplomë të përbashkët, të dyfishtë ose të shumëfishtë, në bashkëpunim me IAL të vendeve të BE-së, kryhet sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara nga vetë IAL-të.

2. Njohja e dokumentacionit të kandidatëve fitues të huaj, në këto programe studimi, mund të kryhet gjatë zhvillimit të semestrit të parë dhe përpara sezonit të parë të provimeve. Regjistrimi si student i kandidatëve fitues bëhet me rezervë, deri në përfundim të procedurës së njohjes së dokumentacionit shkollor të tyre.

3. Kandidatët që aplikojnë në programet e përbashkëta të studimit e paraqesin aplikimin e tyre pranë IAL-së përkatëse. Të dhënat e tyre i dërgohen AKP-së nga IAL-ja në përfundim të procesit të regjistrimit të aplikimeve. Pas zhvillimit të konkurseve/testimeve të pranimit, IAL-ja i

dërgon AKP-së listat e fituesve dhe të dhënat e tyre, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të nevojshëm për zhvillimin e procedurave të njohjes së diplomës.

4. Regjistrimi si student i kandidatëve fitues nga AKP-ja, kryhet me rezervë, deri në përfundim të procedurës së njohjes së dokumentacionit shkollor. Pas përfundimit të njohjes, AKP-ja kryen regjistrimin e tyre përfundimtar me statusin e studentit dhe brenda datës 20 janar 2017 ia komunikon IAL-së.

5. Kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm në institucione arsimore në të njëjtën gjuhë të huaj që zhvillohet edhe programi i përbashkët i integruar i studimit i ciklit të dytë i IAL-së ku aplikon, përjashtohen nga detyrimi i mbrojtjes së kësaj gjuhe sipas përcaktimeve të nenit 76, pika 4, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

UDHËZIM**Nr. 3, datë 27.7.2016****PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
PËR APLIKIMIN PËR REGJISTRIMIN E
NJË KIMIKATI INDUSTRIAL**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 10, të ligjit nr. 9108, datë 17.7.2003, “Për substancat dhe preparatet kimike”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Para hedhjes në treg të kimikatit (substancës/përzjerjes) që do të përdoret për qëllime industriale, prodhuesi dhe/ose importuesi paraqesin në ministri një aplikim me shkrim për regjistrimin e tij, në gjuhën shqipe, sipas formatit në shtojcën 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Çdo kimikat industrial që i nënshtrohet regjistrimit duhet të jetë i regjistruar të paktën në një nga shtetet anëtare të BE-së ose në Agjencinë Evropiane të Kimikateve;



3. Dosja e aplikimit për regjistrimin e çdo substance/përzierje përmban:

a) emrin, mbiemrin, vendbanimin dhe numrin e identifikimit të personit fizik, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare;

b) emrin dhe adresën e personit juridik, të prodhuesit të huaj të substancës së importuar, të detyruar për regjistrim;

c) emrin tregtar të kimikatit;

d) të dhënat për sasinë e kimikatit që regjistrohet;

e) të dhëna mbi qëllimin e përdorimit;

f) të dhënat mbi përbërjen e kimikatit;

g) listën e të dhënave të sigurisë teknike së substancës/përzierjes së rrezikshme, që regjistrohet.

4. Të dhënat për sigurinë teknike të substancës/përzierjes së rrezikshme që regjistrohet, e përmendur në shkronjën “g”, të pikës 3, të këtij udhëzimi, përfshijnë:

a) identifikimi i përzierjes ose substancës;

b) identifikimi i kompanisë ose ndërmarrjes;

c) identifikimi i rrezikut;

d) përmbajtja/informacion mbi përbërësit;

e) masat e ndihmës së parë;

f) masat kundër zjarrit;

g) masat ndaj shkarkimeve aksidentale;

h) mirëmbajtja dhe ruajtja;

i) kontrollet e ekspozimit/mbrojtja e personit;

j) vetitë fizike dhe kimike;

k) stabiliteti dhe reaktiviteti;

l) informacion toksikologjik;

m) informacion ekologjik;

n) konsiderata mbi asgjësimin;

o) informacion mbi transportin;

p) informacion tjetër.

5. Zyra përgjegjëse për kimikatet në Ministrinë e Mjedisit, brenda 60 ditëve nga paraqitja e aplikimit kontrollon plotësimin e dosjes së aplikimit dhe nëse plotësohen kushtet për regjistrim, përcakton numrin e regjistrimit për çdo substance ose përzierje të regjistruar.

6. Zyra përgjegjëse për kimikatet i njofton aplikuesit numrin e regjistrimit dhe lëshon miratimin e regjistrimit për kimikatin në fjalë, sipas formatit të shtojcës 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

7. Nëse nuk plotësohen kushtet për regjistrim, Ministria brenda 30 ditëve, e refuzon regjistrimin.

8. Zyra përgjegjëse për kimikatet, vendos në regjistër, emrin e aplikantit (prodhues apo importues), emrin e kimikatit të regjistruar, sasinë dhe qëllimin e përdorimit;

9. Prodhuesi dhe/ose importuesi që ka regjistruar një kimikat, dërgon të dhënat e sasive të kimikateve që vendos në treg dhe ndryshime të tjera të të dhënave të kimikateve të regjistruara, brenda datës 31 mars të vitit në vijim pas regjistrimit.

10. Prodhuesi dhe/ose importuesi, njofton zyrën e kimikateve për çdo ndryshim të të dhënave të tij, sipas pikës 3 të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT
Lefter Koka



SHTOJCA 1


 REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E MJEDISIT

FORMULARI I KËRKESËS PËR REGJISTRIM TË KIMIKATIT

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____. ____.

Seksioni 1:	Të dhëna mbi prodhuesin/importuesin
Emri i personit fizik/juridik:	_____
Emri tregtar:	_____
Numri i Kodit të Rregjistrimit të _____	NIPT: _____
Adresa e biznesit:	_____
Qyteti: _____	Shteti: _____ Kodi postar: _____
Adresa e emailit:	_____
Telefon: _____	Fax: _____

Seksioni 2:	Te dhëna të pikës së kontaktit
Emri: z/zj	_____
Pozicioni:	_____
Telefon: _____	Fax: _____
Email:	_____

Seksioni 3:	Të dhëna të kimikatit
Emri	_____
Sasia:	_____
Perberja:	_____
Qëllimi i përdorimit	_____

Emri: _____ Pozicioni: _____

Firma: _____ Data: ____ / ____ / ____



SHTOJCA 2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

AKT I REGJISTRIMIT TË KIMIKATIT

Në zbatim të nenit 10 të ligjit 9108, datë 17.07.2003“ Për substancat dhe preparatet kimike”, Ministri

VENDOSI:

Regjistrimin e substancës/përzjerjes si më poshtë:

1. Numri i regjistrimit të kimikatit:
2. Emri dhe/ose kodi tarifor për kimikatin që prodhohet/importohet:
3. Emri i personit fizik/juridik që prodhon/importon:
4. Data e regjistrimit

MINISTRI

Emër mbiemër

(firma, vula)



URDHËR

Nr. 360, datë 22.8.2016

**MBI PROCEDURAT DHE RREGULLAT
PËR REGJISTRIMIN E PAJISJEVE
MJEKËSORE NDRYSHIMET DHE
ANULIMIN E REGJISTRIMIT TË TYRE,
DOKUMENTACIONIN E NEVOJSHËM
DHE KOSTOT PËRKATËSE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë neneve 13, 14, 15 dhe 16, të ligjit nr. 89/2014, “Për pajisjet mjekësore”,

URDHËROJ:

1. Regjistrimin e pajisjeve mjekësore në Regjistrin Kombëtar të Pajisjeve Mjekësore.

2. Aplikimi për regjistrimin e pajisjes mjekësore në regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore paraqitet nga:

a) prodhuesit e pajisjeve mjekësore që kanë të regjistruar aktivitetin në Republikën e Shqipërisë;

b) përfaqësuesit e prodhuesve të huaj që kanë të regjistruar aktivitetin në Republikën e Shqipërisë;

c) tregtuesit me shumicë të pajisjeve mjekësore.

3. Regjistrimi bëhet, për:

- pajisjet mjekësore të të gjitha klasave;

- pajisjeve mjekësore *in vitro*;

- pajisjeve mjekësore të implantueshme aktive;

- pajisjeve mjekësore me porosi;

- sistemet apo paketat procedurale.

4. Aplikimi bëhet pranë Agjencisë së Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM), brenda 15 ditë pune, duke filluar nga data e zhdoganimit të pajisjeve mjekësore.

5. Prodhuesit e pajisjeve mjekësore që kanë të regjistruar aktivitetin në Republikën e Shqipërisë duhet të paraqesin aplikimin për regjistrim brenda 15 ditëve nga dita e lëshimit të certifikatës CE.

6. Për pajisjet me porosi apo ato për hetime klinike, regjistrimi duhet të kryhet para vënies në përdorim.

7. Aplikuesi (administratori ose personi i autorizuar zyrtarisht prej tij), plotëson me të gjitha të dhënat e kërkuara formularin e regjistrimit të pajisjeve mjekësore që i bashkëlidhet këtij urdhri, e firmos, vulos dhe e dorëzon pranë

AKBPM-së me të dhëna që regjistrohen në regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore.

8. AKBPM-ja lëshon një certifikatë për regjistrimin e pajisjes mjekësore në regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së aplikimit. Deri në pajisjen e subjektit me certifikatën e regjistrimit subjekti vazhdon rregullisht vendosjen në treg të pajisjes.

9. Pas regjistrimit të pajisjes në regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore, mbajtësi i certifikatës së regjistrimit njofton për çdo ndryshim të dokumentacionit, në bazë të të cilit AKBPM-ja ka bërë regjistrimin. Në rast ndryshimesh, mbajtësi i certifikatës së regjistrimit të paraqesë kërkesën për ndryshim në AKBPM. Nëse ndryshimi kërkon një ndryshim të vendimit për regjistrimin në regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore, AKBPM-ja bën ndryshimin përkatës në regjister.

10. AKBPM-ja bën ose në rastet kur dokumentacioni nuk është i plotë apo paraqet parregullsi, refuzon të bëjë regjistrimin e ndryshimit në regjistrin përkatës, në varësi të llojit të tij, brenda 30 ditëve nga data e marrjes të dokumentacionit të ndryshimit.

11. Nëse kërkesa për regjistrim, ndryshim apo anulim të regjistrimit në regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore nuk është e plotë, ose në qoftë se aplikimi nuk është i mbështetur në të dhënat dhe dokumentet e kërkuara, AKBPM-ja fton aplikuesin, me shkrim, për të ndrequr mangësitë dhe për të paraqitur të dhënat e kërkuara dhe dokumentet brenda 30 ditëve nga data e pranimin të aplikimit. Afati i përmendur në pikën 10, të këtij urdhri, nuk do të zbatohet deri në çastin e dhënies nga aplikuesi të një shpjegimi në formë të shkruar.

12. Aplikuesi ka të drejtë të paraqesë me shkrim ankimin në Ministrinë e Shëndetësisë, në lidhje refuzimin e regjistrimit, ndryshimet apo anulimin e regjistrimit në regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore.

13. AKBPM-ja anulon regjistrimin nga regjistri kombëtar i pajisjeve mjekësore në rastet e mëposhtme:

a) me kërkesën e vetë mbajtësit të certifikatës së regjistrimit;

b) *ex officio*, nëse vërtetohet se prodhuesi,



përfaqësuesi i prodhuesit dhe tregtuesi me shumicë kanë qenë të regjistruar në kundërshtim me kërkesat e këtij urdhri dhe dispozitat e ligjit nr. 89/2014, “Për pajisjet mjekësore” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

14. AKBPM-ja bën anulimin e regjistrimit të pajisjes mjekësore nga regjistri kombëtar i pajisjeve mjekësore brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës nga mbajtësi i certifikatës së regjistrimit ose vërtetimit të fakteve, sipas pikës 13, shkronja “b”, të këtij urdhri.

15. Plotësimi i formularit dhe regjistrimi në regjistrin e pajisjeve mjekësore do të bëhet në gjuhën shqipe.

16. Së bashku me formularin e përmendur në pikën 7, aplikuesi të paraqesë:

a) Fotokopje të certifikatës së konformitetit CE ose deklaratës së konformitetit për pajisjet e klasës I dhe listën e standardet përkatëse për atë certifikatë;

b) Për pajisjet me porosi dhe ato për hetime klinike, të paraqitet deklarata sipas aneksit VIII, deklaratë për pajisjet me qëllim të veçantë sipas VKM-së nr. 731, datë 2.9.2015, “Për kërkesat

thelbësore, vlerësimin e konformitetit, klasifikimin dhe markimin CE të pajisjeve mjekësore”;

c) Dokumentin e kryerjes së pagesës për kryerjen e aplikimit. Pagesa për aplikim është 500 lekë dhe kryhet në një bankë të nivelit të dytë.

17. Regjistrimi cakton një numër identifikimi për çdo operator në Regjistrin Kombëtar të Pajisjeve Mjekësore.

18. Për pajisjet e të njëjtit prodhues dhe që vendosen në treg nga i njëjti tregtues me shumicë mund të bëhet një regjistrim i vetëm për grup pajisjesh kur pajisjet përfshihen në të njëjtën certifikatë konformiteti.

19. Ministria e Shëndetësisë monitoron zbatimin e procedurave të regjistrimit nëpërmjet raportimeve periodike mujore të AKBPM-së dhe aksesit në regjistrin e pajisjeve mjekësore. Raportimi bëhet brenda datës 20 të çdo muaji pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

Ky urdhër botohet në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 26.8.2016.

MINISTRI I SHËNDETËSISË
Ilir Beqaj

FORMULARI I REGJISTRIMIT TË PAJISJEVE MJEKËSORE

A Të dhëna administrative	
Lloji i regjistrimit	
☐	Regjistrimi i parë
☐	Ndryshim informacioni
☐	Numri i mëparshëm i regjistrimit (në rast ndryshimi)
	Data

B Informacion mbi aplikuesin	
Statusi i aplikuesit	
☐	prodhues i pajisjeve mjekësore që ka të regjistruar aktivitetin në Republikën e Shqipërisë
☐	përfaqësues i prodhuesit të huaj që ka të regjistruar aktivitetin në Republikën e Shqipërisë
☐	tregtues me shumicë i pajisjeve mjekësore

Informacion mbi prodhuesin e pajisjeve mjekësore që ka të regjistruar aktivitetin në Republikën e Shqipërisë	
Emri	
Emri i personit të kontaktit	
Adresa	Qyteti/shteti



Telefoni/fax

Emaili

D	Informacion mbi përfaqësuesin e prodhuesit të huaj që ka të regjistruar aktivitetin në Republikën e Shqipërisë	
Emri i subjektit		
Emri i personit të kontaktit		
Adresa		Qyteti/shteti
Telefoni/fax		
Emri i prodhuesit që përfaqëson		
Adresa kryesore e prodhuesit në vendin e regjistrimit		Qyteti/shteti
Telefoni/fax		
Emaili		
E	Informacion mbi tregtuesin me shumicë të pajisjeve mjekësore	
Emri i subjektit		
NIPT Numri dhe data e autorizimit për tregtim me shumicë, lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë		
Distributor i autorizuar për Shqipërinë? Nëse po të bashkëngjitet marrëveshja e bashkëpunimit		
Emri i administratorit		
Emri i personit të kontaktit		
Adresa		Qyteti/shteti
Telefoni/Fax		
Emaili		

F	Informacion mbi pajisjen mjekësore	
	Pajisje mjekësore	
	Klasa I	
	Pajise me funksione matës	
	Pajisje sterile	



	Klasa II a	
	Klasa II b	
	Klasa III	
	Të implantueshme aktive	
	In vitro	
	Sistem ose paketë procedurale	
	Pajisje me porosi (në pikën “komente” të shënohet emri i mjekut dhe pacientit)	
	Pajisje për hetime klinike	
	Kodi i nomenklaturës doganore	
	Kodi GMDN ose UMDN	
	Kodi i nomenklaturës (nëse jo GMDN apo UMDN)	
	Kategoria	
1	Pajisje të implantueshme aktive	
2	Pajisje anestezie dhe respiratore	
3	Pajisje dentare	
4	Pajisje elektromekanike	
5	Pajisje mobilim spitalor	
6	Pajisje të diagnostikimit in vitro	
7	Pajisje të implantueshme jo aktive	
8	Pajisje oftalmike dhe optike	
9	Instrumente shumëpërdorimëshe	
10	Pajisje njëpërdorimëshe	
11	Pajisje asistive për persona me aftësi të kufizuar	
12	Pajisje diagnostikuese dhe terapeutike me rrezatim	
13	Pajisje terapie komplementare	
14	Pajisje me prejardhje biologjike	
15	Produkte për institucione të kujdesit shëndetësor	
16	Pajisje laborator	
17	Tjetër	
	Përshkrimi i përgjithshëm i pajisjes, përshkrimi i qëllimit të synuar të përdorimit të pajisjes	
	Prodhuesi	
	Modeli	
G	Informacion mbi organin e miratuar	
	Emri	
	Numri i trupit të miratuar	



	Numri i certifikatës CE	
	Linku ku gjendet kjo certifikatë në websitin zyrtar të kompanisë apo të trupit të notifikuar	
	Data e lëshimit data e skadencës	
	Lista e standardeve që plotëson pajisja	
	Për pajisjet e klasës I	
	Fotokopje e deklaratës së konformitetit	
	Linku ku gjendet kjo certifikatë në websit-in zyrtar të kompanisë	
	Lista e standardeve që plotëson pajisja	

H Komente

Konfirmoj që informacioni i dhënë më lart është i saktë

Firma e administratorit ose personit të autorizuar prej tij (në rastin e personit të autorizuar, të bashkëngjitet autorizimi)

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 168 lekë